

Flash

Korçë, i shpallur në kërkim 2 ditë më parë për grup kriminal, në pranga Ergis Zenelak

3Informacion në rrugë operative 'Po e shesin', policia në aksion prangos 3 persona në Vlorë! Makina e mbushur me drogë

4'Motra jote është paguar'...pas komenteve negative për Beatrix, vëllai i saj, Albani merr vendimin që pritej

5I shpallur në kërkim ndërkombëtar, arrestohet 44-vjeçari në Morinë me qëllim ekstradimi në Paris

Kronikë

Banorët e Shënkollit me armë te koka për t'u mbrojtur nga vjedhjet, policia i gjen hajdutët pas denoncimit në Report Tv! Arrestohen 2 të rinj, 1 tjetër në hetim

Një ditë pas denoncimit të banorëve të Shënkollit në Report Tv se flinin me armë tek koka pasi hajdutët po bënin kërkinë me vjedhjet, forcat Shqiponja kanë arrestuar dy të rinj të rinjtë shkonin nga Tirana në Lezhë për të vjedhur dhe rezultojnë

Frikë nga hajdutët, lezhjanët e gdhijnë me armë te koka e krevatit! Gra e burra bëjnë roje: Kjo s'është polici shteti por pushteti! Kemi frikë në shtëpitë tona (VIDEO)



Automatiku dhe fishekët e sekuestruar

[Sh] Redaksia

29 Nëntor, 15:52 | Përditesimi i fundit: 29 Nëntor, 17:02

A A

LEZHË- Një ditë pas denoncimit të banorëve të Shënkollit në Report Tv se flinin me armë tek koka pasi hajdutët po bënin kërkinë me vjedhjet, policia e Lezhës është vënë në lëvizje. Pas informacioneve se do të kryhej një tjetër vjedhje, forcat Shqiponja kanë kapur mat dy të rinj, të cilët janë arrestuar, ndërsa një tjetër është vënë nën hetim.

Të tre të rinjtë shkonin nga Tirana në Lezhë për të vjedhur, ndërsa mësohet se dy prej tyre ishin të mitur, L.Xh.,17 vjeç i cili u arrestua dhe L.Gj.,16 vjeç që u vu nën hetim. Në pranga ka rënë edhe 22-vjeçari Jurgen Beqiraj. Forcat Shqiponja bënë të mundur ndalimin e tyre, të cilët po udhëtonin me një mjet dhe ishin të pajisur me një armë zjarri automatik. Gjithashtu në mjet iu gjendën edhe sende që dyshohen se janë të vjedhura, të cilat u sekuestruan sëbashku me automatikun dhe 90 fishekë.

[Sh] LEXO EDHE:

Duke pirë raki në sofër tradicionale, surprizon deputetja: Jam nuse mirditore, sot je në besën time...nga tradita te 'tradhtia' me LSI-në

Lidhur me këtë situatë shqetësuese në Lezhë, e cila vijon prej gati dy muajsh, burime për Report Tv bëjnë me dije se është hartuar një plan masash. Që prej mbrëmjes së kaluar po bëhen monitorime gjatë natës nga agjentë civilë të policisë me qëllim goditjen e personave të cilët po kryejnë vjedhje në fshatrat e Lezhës.

Sipas Policisë, tre të rinjtë janë autorë të disa vjedhjeve të tjera në Lezhë, ndërkohë që ndaj tyre rëndojnë akuzat për veprat penale, "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyes dhe municionit ", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta ", kryer në bashkëpunim dhe "Moskallëzimi i krimit".

Një ditë më parë banorët e Shënkollit **denoncuan në Report Tv** se ishin të detyruar të flinin me armë tek koka për të ruajtur shtëpitë e tyre pasi hajdutët vjedhin çdo natë nga një shtëpi në Lezhë. Ata nuk i besojnë policisë, pasi sipas tyre elementë të saj janë të lidhur me hajdutët.

Kujtojmë që blutë e Lezhës zbarkuan mbrëmë në shtëpinë e Nikoll Pashukut i cili doli me armë në dorë, në një intervistë për Report Tv, ku denoncoi vjedhjet në zonën e Shënkollit dhe tha se ishte i detyruar që të pajisej me armë me leje për t'u mbrojtur nga grabitësit.

Referuar të dhënave vetëm gjatë 2 muajve të fundit në fshatrat e Shënkollit kanë ndodhur rreth 50 vjedhje. Pak ditë më parë policia arrestoi babë e bir, ndërsa një person tjetër u shpall në kërkim. Ata dyshohet të jenë autor të disa vjedhjeve në zona të ndryshme të Lezhës, përfshirë dhe Shënkollin.

SI.E./B.K./Shqiptarja.com

TAG: Lezhe vjedhje shenboll Nikoll Pashuku

Komento

Komente

Polic: 30/11/2021 21:17

Po pse per budallej na mirrni o??? Kapen dy te mitur me arme dhe direkt i vishni 700 krime qe kane ndodhur ne Lezhe!!

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[SH] Sondazhi i ditës:

Çfarë mendoni se do të krijojë situata në PD me mbledhjen e dy Kuvendeve?

Përçarje Bashkim Parti të re

Lajme të tjera

Kronikë

Kruja dhe Kurbini mbulohen nga mjegulla e dendur! Mjetet qarkullojnë me vështirësi

4 Dhjetor, 21:26

Sociale

Ura e 'vdekjes' mbi lumin Gjadër pa barriera mbrojtëse, premtime politike por asnjë investim! Banorët për Report Tv: Një makinë ra duke shkuar për të marrë nusen

Elvis Hila

4 Dhjetor, 11:59

Politikë

Jep dorëheqjen kryetari i PD-së në Lezhë, Zef Gjoka

3 Dhjetor, 11:10

Kronikë

Arsenal armësh në shtëpi dhe kanabis, arrestohet 60 vjeçari në Lezhë! Iu gjetën eksploziv, granata, qindra fishekë e armë

3 Dhjetor, 09:21

Kronikë

Tentativa e vjedhjes në shtëpinë e drejtorit të shkollës, arrestohet bashkëpunëtori! Elio Hila u dëmtua në vendin e ngjarjes, prangoset në një spital privat në Tiranë

3 Dhjetor, 08:27

Politikë

Kallëzimi 2 efektivëve në qershor, Prokuroria e Lezhës vendos mosfillimin e hetimeve për Pjerin Ndreun: S'ka elementë të veprës penale

Elvis Hila

2 Dhjetor, 18:01

HOROSKOPI